



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria – Vlada - Government*

*Ministria e Shëndetësisë - Ministarstvo Zdravstva – Ministry of Health*

**UDHËZIMIN ADMINISTRATIV (Shëndetësi) NR. 05/2023**  
**VËREJTJET E KOMBINUARA**

## **Ministri i Ministrisë së Shëndetësisë,**

Ministri i Ministrisë së Shëndetësisë, në mbështetje të nenit Neni 6 paragrafi, 13, 18 dhe 19 të Ligjit Nr.04/L-156 Për Kontrollin e Duhanit (Gazeta Zyrtare Nr. 13, 07/05/ 2013), Shtojcën 1, paragrafi 6 nënparagrafi 6.1 të Rregullores Nr. 14/2023 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive si dhe nenit 38 paragrafit 6 të Rregullores së Punës së Qeverisë Nr.09/2011 (Gazeta Zyrtare Nr. 15, 12.09.2011),

Nxjerr:

### **UDHËZIMIN ADMINISTRATIV NR. 05/ 2023 VËREJTJET E KOMBINUARA**

#### **Neni 1 Qëllimi**

1. Ky Udhëzim Administrativ përcakton rregullat për vendosjen e fotografive me ngjyra apo ilustrimeve të tjera dhe tekstit në paketimet e produkteve të duhanit ose të ngjashme për të:

1.1. ngritur njohuritë e duhanpirësve mbi efektet shëndetësore që shkakton përdorimi i produkteve të duhanit;

1.2. siguruar efekt të vazhdueshëm të vërejtjeve shëndetësore në paketimet e produkteve të duhanit;

1.3. inkurajuar ndërprerjen e pirjes së duhanit dhe dekurajuar nisjen ose rinisjen e pirjes së duhanit.

2. Ky Udhëzim Administrativ është përafuar pjesërisht me Direktivën 2014/40/EU të Parlamentit Evropian dhe Këshillit e 3 prillit 2014 mbi përafrimin e ligjeve, rregulloreve dhe dispozitave administrative të Shteteve anëtare në lidhje me prodhimin, paraqitjen dhe shitjen e duhanit dhe të produkteve të përafërta dhe shfuqizimin e Direktivës 2001/37/EC Gazeta Zyrtare Nr. L 127/1.

#### **Neni 2 Fusha e zbatimit**

Ky Udhëzim Administrativ do të zbatohet në paketimet e të gjitha llojeve të produkteve të duhanit për tymosje, produkteve të duhanit që nuk tymosen dhe produktet e reja të duhanit.

#### **Neni 3 Përkufizimet**

1. Për qëllime të këtij Udhëzimi Administrativ, do të zbatohen përkufizimet e përcaktuara në nenin 2 të Ligjit për Kontrollin e Duhanit Nr.04 /L-156 dhe këto përkufizime:

1.1. 'Paketim i jashtëm' nënkupton çdo formë të paketimit i cili përmban një apo më shumë paketime njësi dhe që del në treg; mbështjellësit transparent nuk konsiderohen si paketim i jashtëm;

1.2. 'Paketim njësi' nënkupton paketimin më të vogël individual të produkteve të duhanit ose të ngjajshme që dalin në treg;

1.3. 'Qese xhepi' nënkupton një paketim njësi që përmban produkte të duhanit për tymosje që mund të jetë në formëtë një xhepi drejtkëndësh me llapë ose në formë të një qese e cila qëndron vertikalisht;

1.4. 'Vërejtje shtesë' nënkupton tekstin përcjellës të fotografisë në vërejtjen e kombinuar të paraqitur në librarinë e vërejtjeve shëndetësore;

1.5. 'Vërejtje e kombinuar' nënkupton vërejtje e përbërë nga fotografia apo ilustrimi tjetër dhe teksti përkatës i vërejtjes shtesë i përcaktuar në Librarinë e vërejtjeve shëndetësore;

1.6. 'Libraria e vërejtjeve shëndetësore' nënkupton dokumentin e vënë në dispozicion nga Ministria e Shëndetësisë i cili përmban vërejtjet e kombinuara, vërejtjet e përgjithshme dhe mesazhin informues;

1.7. 'Duhan për thithje me llullë' nënkupton duhanin apo produktet e duhanit që mund të përdoret përmes procesit të djegjes dhe ekskluzivisht për përdorim me llullë;

1.8. 'Duhan mbështjellë-vet' nënkupton duhanin apo produktet e duhanit që mund të përdoret për të bërë cigaret nga vet konsumatori apo shitësi me pakicë;

1.9. 'Duhan për çibuk me ujë apo nargjile' nënkupton duhanin apo produktet e duhanit që konsumohen nëpërmjet çibukut që përdor sistem me tuba uji;

1.10. 'Produkt i duhanit që nuk tymoset' nënkupton produktet e duhanit që nuk kalojnë nëpër procesin e tymosjes, duke përfshirë duhanin për përlypje, për përdorim me hundë dhe për përdorim oral;

1.11. 'Produkt i duhanit për tymosje' nënkupton produktet e tjera të duhanit, prej produkteve që nuk tymosen dhe përfshijnë por nuk kufizohen në: cigaret, produkte të duhanit për ngrohje, duhanin për thithje me llullë, duhanin mbështjelle-vet, duhanin për çibuk me ujë apo nargjile, purot dhe cigarillot;

1.12. 'Produkt i duhanit i ri' nënkupton produktet e duhanit të cilat:

1.12.1. nuk i takojnë kategorive të mëposhtme: cigareve, produkteve të duhanit për ngrohje, duhanit mbështjelle-vet, duhanit për llullë, duhanit për çibuk me ujë, cigareve puro, cigarillove, duhanit që përlypjet, duhanit për përdorim me hundë, duhanit për përdorim oral; dhe

1.12.2. dalin në treg pas miratimit të këtij Udhëzimi Administrativ.

#### **Neni 4**

### **Libraria e vërejtjeve shëndetësore**

1. Me hyrjen në fuqi të këtij Udhëzimi Administrativ, Ministria e Shëndetësisë do të sigurojë dokumentacionin -Librarinë e vërejtjeve shëndetësore që përmban tre shtojca:

Shtojca 1: Vërejtjet shëndetësore të kombin-uara, vërejtjet e përgjithshme dhe mesazhi informues,

Shtojca 2: Ilustrimet e vendosjes së vërejtjeve shëndetësore në paketimet e produkteve të duhanit, dhe

Shtojca 3: Vërejtjet shëndetësore për paketimet e produkteve të duhanit për tymosje në formë kuboide.

2. Specifikimet teknike për shtypjen e vërejtjeve shëndetësore duhet të jenë në përputhje me nenin 9 të këtij Udhëzimi Administrativ.

3. Specifikimet teknike për shtyp mund të ndryshohen vetëm nga Ministria e Shëndetësisë.

4. Libraria e vërejtjeve shëndetësore përditësohet në baza vjetore me vendim nga Ministri i Shëndetësisë.

5. Libraria e vërejtjeve shëndetësore do të vihet në dispozicion si shtojcë e këtij Udhëzimi Administrativ.

#### **Neni 5**

### **Vërejtjet e përgjithshme dhe mesazhi informues në produktet e duhanit që tymosen**

1. Çdo paketim njësi dhe çdo paketim i jashtëm i produkteve të duhanit për tymosje duhet të përmbajë:

1.1. vërejtjen e përgjithshme sipas Librarisë së vërejtjeve shëndetësore;

1.2. mesazhin informues: 'Tymi i duhanit përmban mbi shtatëdhjetë (70) substanca që shkaktojnë kancerin';

1.3. vërejtjen e përgjithshme dhe mesazhi informues duhet të shtypen në të dyja gjuhët, në gjuhën shqipe dhe në gjuhën serbe.

2. Për paketimet e produkteve të duhanit për tymosje në formë kuboide vërejtja e përgjithshme duhet të paraqitet në pjesën e poshtme të sipërfaqes anësore të dukshme të paketimit njësi, ndërkaq mesazhi informues duhet të paraqitet në pjesën e poshtme të sipërfaqes tjetër anësore të dukshme të paketimit njësi.

3. Për paketimet e produkteve të duhanit për tymosje në formë të qeses së xhepit me një palosje, vërejtja e përgjithshme duhet të paraqitet në pjesën e lartë të sipërfaqes së brendshme të llapës së qeses dhe mesazhi informues duhet të paraqitet në pjesën e lartë të anës së përparme të xhepit.

4. Për paketimet e produkteve të duhanit për tymosje në formë të qeses së xhepit me dy palosje, vërejtja e përgjithshme duhet të paraqitet në pjesën lartë të sipërfaqes së brendshme të llapës së qeses dhe mesazhi informues duhet të paraqitet në pjesën e lartë të anës së përparme të xhepit.

5. Për paketimet e produkteve të duhanit për tymosje në formë të qeses së xhepit që qëndron vertikalisht, vërejtja e përgjithshme duhet të paraqitet në njëren gjysmë të bazës së qeses dhe mesazhi informues duhet të paraqitet në gjysmën tjetër të bazës së qeses.

6. Për paketimet e produkteve të duhanit për tymosje në formë cilindrike, vërejtja e përgjithshme duhet të paraqitet në sipërfaqen e jashtme të kapakut dhe mesazhi informues duhet të paraqitet në sipërfaqen e brendshme të kapakut.

7. Për paketimet e produkteve të duhanit për tymosje në formë të kutisë-krah me kapak që varet, vërejtja e përgjithshme duhet të paraqitet në pjesën e lartë të sipërfaqes ballore të dukshme të paketimit njësi dhe mesazhi informues duhet të paraqitet në pjesën e lartë të sipërfaqes anësore të dukshme të paketimit njësi. Vërejtjet duhet të vendosen në pjesën e lartë të sipërfaqes së rezervuar për ato, menjëherë përfundi buzës së poshtme të kapakut.

8. Për paketimet e produkteve të duhanit për tymosje në formë të kutisë-krah me kapak që hiqet, vërejtja e përgjithshme duhet të paraqitet në pjesën e lartë të sipërfaqes së pasme të dukshme të paketimit njësi dhe mesazhi informues duhet të paraqitet në pjesën e lartë të sipërfaqes anësore të dukshme të paketimit njësi. Vërejtjet duhet të vendosen në pjesën e lartë të sipërfaqes së rezervuar për ato, menjëherë përfundi buzës së poshtme të kapakut.

9. Për paketimet e produkteve të duhanit për tymosje në formë të një tubi cilindrik njësh për puro, vërejtja e përgjithshme duhet të paraqitet në 65% të sipërfaqes së përgjithshme të tubit.

10. Vërejtja e përgjithshme dhe mesazhi informues, duhet të mbulojnë 65% të sipërfaqes në të cilën shtypen.

11. Vërejtja e përgjithshme dhe mesazhi informues duhet të:

11.1. shtypen në fontin e zi Helvetik të theksuar dhe në sfond të verdhë;

11.2. shtypen në qendër të sipërfaqes së rezervuar për ato dhe të shtrihet në proporcionin më të madh të mundshëm të sipërfaqes së rezervuar për këto vërejtje;

11.3. shtypen paralelisht me skajin e sipërfaqes anësore të paketimit njësi dhe të paketimit të jashtëm në formë të kuboidit.

12. Vërejtjet e përgjithshme duhet të korrespondojnë më vërejtjet e kombinuara ashtu siç janë të paraqitura në Librarinë e vërejtjeve shëndetësore.

13. Dukja dhe vendosja e vërejtjeve të përgjithshme dhe mesazhit informues në paketim duhet të bëhet sipas mënyrës së ilustruar në Librarinë e vërejtjeve shëndetësore.

## **Neni 6**

### **Vërejtjet e kombinuara për produktet e duhanit për tymosje**

1. Çdo paketim njësi dhe çdo paketim i jashtëm i produkteve të duhanit për tymosje duhet të përmbajë vërejtjet e kombinuara.
2. Vërejtja e kombinuar përveç fotografisë me ngjyra dhe vërejtjes shtesë mund të përmbajë edhe informacione për ndërprerjen e duhanit siç janë numri i telefonit, e-mail adresa ose faqet e internetit, që kanë për qëllim të informojnë duhanpirësit për programet në dispozicion të cilat ndihmojnë personat që dëshirojnë të ndërprerjen përdorimin e duhanit. Këto informacione mund të vendosen vetëm kur përcaktohen dhe kërkohen nga Ministria e Shëndetësisë.
3. Vërejtja e kombinuar në anën e përparme duhet të jetë në gjuhën shqipe dhe në anën e pasme duhet të jetë në gjuhën serbe.
4. Vërejtja e kombinuar duhet të mbulojë 65% të sipërfaqes së dukshme të anës së përparme dhe 65% të sipërfaqes së dukshme të anës së pasme të paketimit njësi dhe të çdo paketimi të jashtëm.
5. Vërejtjet e kombinuara duhet të paraqiten në pjesën e lartë të paketimit njësi dhe paketimit të jashtëm dhe të pozicionohen në të njëjtin drejtim me informacionet e tjera të paraqitura në atë sipërfaqe të paketimit.
6. Përjashtimisht nga paragrafi i mësipërm, tek paketimet njësi të produkteve të duhanit në formë kuboide me kapak “flip top” vërejtjet e kombinuara duhet të paraqiten në pjesën e poshtme të paketimit.
7. Për paketimet e produkteve të duhanit për tymosje në formë kuboide, vërejtja e kombinuar duhet të paraqitet në anën e përparme dhe të pasme të dukshme të paketimit njësi dhe të çdo paketimi të jashtëm.
8. Për paketimet e duhanit për tymosje në formë të qeses së xhepit me një palosje, vërejtja e kombinuar duhet të paraqitet në anën e përparme të dukshme qeses (sipërfaqja e jashtme e llapës) dhe në anën e pasme të dukshme të qeses së xhepit.
9. Për paketimet e produkteve të duhanit për tymosje në formë të qeses së xhepit me dy palosje, vërejtja e kombinuar duhet të paraqitet në anën e përparme të dukshme të qeses (pjesën e lartë) dhe në anën e pasme të dukshme të qeses (pjesën e lartë).
10. Për paketimet e produkteve të duhanit për tymosje në formë të qeses së xhepit që qëndron vertikalisht, vërejtja e kombinuar duhet të paraqitet në pjesën e lartë të dukshme të anës së përparme dhe të pasme të qeses. Për qeset të cilat mbyllën me “zinxhir” apo mbyllje tjetër, duhet të jenë të pozicionuara përfundim “zingjirit” apo mbylljes tjetër.

11. Për paketimet e produkteve të duhanit për tymosje në formë cilindrike, të dy vërejtjet e kombinuara duhet të pozicionohen në distancë të njëjtë nga njëra tjetra dhe secila duhet të mbulojë 65% të gjysmës së sipërfaqes së përgjithshme të paketimit cilindrik. Vërejtjet duhet të vendosen në pjesën e lartë të sipërfaqes së rezervuar për ato, menjëherë përfundi buzës së poshtme të kapakut.

12. Për paketimet e produkteve të duhanit për tymosje në formë të kutisë kuboide që qëndron horizontalisht me kapak që varet, vërejtja e kombinuar duhet të paraqitet në anën e dukshme të përparme të paketimit njësi (sipërfaqen e jashtme të kapakut) dhe në sipërfaqen e brendshme të kapakut. Vërejtjet duhet të vendosen në pjesën e lartë të sipërfaqes së rezervuar për ato.

13. Për paketimet e produkteve të duhanit për tymosje në formë të kutisë kuboide, që qëndron horizontalisht me kapak që hiqet, vërejtja e kombinuar duhet të paraqitet në anën e dukshme të përparme të paketimit njësi (sipërfaqen e jashtme të kapakut) dhe në sipërfaqen e brendshme të kapakut. Vërejtjet duhet të vendosen në pjesën e lartë të sipërfaqes së rezervuar për ato.

14. Pavarësisht madhësisë së paketimit njësi të cigareve, vërejtja e kombinuar duhet të ketë këto dimensione:

14.1. gjatësia: jo më pak se 44 mm;

14.2. gjerësia: jo më pak se 52 mm.

15. Vërejtjet e kombinuara duhet:

15.1. secila nga vërejtjet e kombinuara duhet të shtypet në numër të barabartë të njësive të paketimit.

15.2. të gjitha vërejtjet e kombinuara duhet të jenë të shtypura në numër të barabartë të paketimeve njësi brenda një paketimi të jashtëm, që të jenë të ndryshme nga njëra tjetra.

16. Vërejtja shtesë duhet të:

16.1. shtypet në fontin e bardhë Helvetik të theksuar dhe në sfond të zi;

16.2. shtypet në qendër të sipërfaqes së rezervuar për ato dhe të shtrihet në proporcionin më të madh të mundshëm të sipërfaqes së rezervuar për këto vërejtje.

17. Dukja dhe vendosja e vërejtjeve të kombinuara në paketimin e produkteve të duhanit duhet të bëhet sipas mënyrës së ilustruar në Librarinë e vërejtjeve shëndetësore.

## **Neni 7**

### **Vërejtjet shëndetësore për produktet e duhanit që nuk tymosen**

1. Çdo paketim njësi dhe çdo paketim i jashtëm i produkteve të duhanit që nuk tymoset duhet të ketë vërejtjen shëndetësore të përgjithshme në vijim: "Ky produkt i duhanit dëmton shëndetin tuaj dhe krijon varësi."

2. Vërejtja shëndetësore e përcaktuar në paragrafin 1, duhet të përputhet me kërkesat e specifikuara në Nenin 5, paragrafi 11 të këtij udhëzimi administrativ. Teksti i vërejtjeve shëndetësore duhet të jetë paralel me tekstin kryesor në sipërfaqen e rezervuar për këto vërejtje. Përveç kësaj, ato duhet të:

2.1.paraqiten në të dy sipërfaqet më të mëdha të paketimit njësi dhe çdo paketimi të jashtëm;

2.2. mbulojnë 32% të sipërfaqes së paketimit njësi dhe çdo paketimi të jashtëm.

### **Neni 8**

#### **Produktet e duhanit të reja**

Produktet e reja të duhanit që mund të dalin për qarkullim në treg duhet të zbatojnë kërkesat e këtij Udhëzimi Administrativ.

### **Neni 9**

#### **Integriteti vizual i vërejtjeve shëndetësore**

(Vërejtjet e kombinuara, vërejtjet e përgjithshme dhe mesazhi informues)

Vërejtjet shëndetësore në paketimet njësi dhe në çdo paketim të jashtëm duhet të jenë të shtypura në mënyrë që nuk mund të hiqen, të jenë të pashlyeshme dhe plotësisht të dukshme, përfshirë që të mos jenë pjesërisht apo plotësisht të fshehura apo të ndërprera nga banderollat apo pullat tatimore, shenjëzimet e çmimeve, karakteristikat e sigurisë, mbështjellësit, mëveshët, kutitë apo mjetet e tjera. Në paketimet njësi të produkteve të duhanit ndryshe nga cigaret, produktet e duhanit për ngrohje dhe duhanit në qese, vërejtjet shëndetësore mund të fiksohen në formë të fletë-ngjitjes me kusht që nuk mund të shkoqiten apo hiqen. Redaktimi i madhësisë së vërejtjeve të kombinuara duhet të bëhet në shkallë proporcionale. Fotografia dhe teksti duhet të jenë të qarta dhe të lexueshme, pa shtrembërim dhe zbehe të cilësisë në çfarëdo mënyre.

### **Neni 10**

#### **Gjobat mandatore dhe dënimet**

Subjektet që shkelin dispozitat e këtij Udhëzimi Administrativ, do të ndëshkohen në bazë të nenit 21, paragrafi 1 të Ligjit për Kontrollin e Duhanit.

### **Neni 11**

#### **Zbatimi**

1. Të gjitha produktet e duhanit të cilat importohen apo prodhohen për tregun e Republikës së Kosovës, më së voni gjashtë (6) muaj muaj pas hyrjes në fuqi të këtij udhëzimi, duhet të përmbajnë vërejtjet shëndetësore të përcaktuara në këtë Udhëzim Administrativ.

2. Të gjitha produktet e duhanit të cilat qarkullojnë në territorin e Republikës së Kosovës, dymbëdhjetë (12) muaj pas hyrjes në fuqi të këtij udhëzimi, duhet të përmbajnë vërejtjet shëndetësore të përcaktuara në këtë Udhëzim Administrativ.

3. Dymbëdhjetë (12) muaj pas hyrjes në fuqi të këtij Udhëzimi Administrativ, në territorin e Republikës së Kosovës ndalohet qarkullimi në treg i të gjitha produkteve të duhanit që nuk përmbajnë vërejtjet shëndetësore të përcaktuara në këtë Udhëzim Administrativ.

## **Neni 12**

### **Shtojcat**

Shtojca 1: Vërejtjet shëndetësore të kombin-uara, vërejtjet e përgjithshme dhe mesazhi informues,

Shtojca 2: Ilustrimet e vendosjes së vërejtjeve shëndetësore në paketimet e produkteve të duhanit, dhe

Shtojca 3: Vërejtjet shëndetësore për paketimet e produkteve të duhanit për tymosje në formë kuboide.

## **Neni 13**

### **Hyrja në fuqi**

Ky Udhëzim Administrativ hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas nënshkrimit nga ana e Ministrit dhe publikimit në Gazetën Zyrtare.

Dr. Arben Vitia

---

Ministër i Shëndetësisë  
21.09.2023

## Libraria e Vërejtjeve Shëndetësore - SHTOJCA 1

### VËREJTJET SHËNDETËSORE TË KOMBINUARA, VËREJTJET E PËRGJITHSHME DHE MESAZHI INFORMUES

#### Udhëzime:

- i. Vërejtjet e kombinuara dhe vërejtjet e përgjithshme duhet të korrespondojnë me njëra tjetrën ashtu siç janë paraqitur më poshtë në këtë dokument, të grupuara në 10 lloje të vërejtjeve të renditura me numër rendor nga 1 deri në 10.
- ii. Çdo paketim i produkteve të duhanit për tymosje duhet të përmbajë vërejtjen e kombinuar, vërejtjen e përgjithshme dhe mesazhin informues.
- iii. Mesazhi informues është i njëjtë për të gjitha paketimet e produkteve të duhanit për tymosje: ***"Tymi i duhanit përmban mbi shtatëdhjetë (70) substanca që shkaktojnë kancerin"***.
- iv. Çdo paketim i produkteve të duhanit që nuk tymoset duhet të ketë vërejtjen shëndetësore të përgjithshme: ***"Ky produkt i duhanit dëmton shëndetin tuaj dhe krijon varësi"***.
- v. Vërejtjet shëndetësore për paketimet e produkteve të duhanit për tymosje në formë kuboide duhet të merren nga shtojca-3 e librarisë së vërejtjeve shëndetësore. Këto vërejtje janë të formatizuara, me rezolucion dhe cilësi të lartë.
- vi. Mënyra e vendosjes së vërejtjeve shëndetësore për forma të ndryshme të paketimeve të produkteve të duhanit është e ilustruar në shtojcën-2 të librarisë së vërejtjeve shëndetësore.
- vii. Fotografitë me cilësi të lartë të vërejtjeve të kombinuara për të gjitha paketimet e produkteve të duhanit, përveç atyre për paketimet në formë kuboide (këto merren nga shtojca numër 3), mund të shkarkohen në linkun <https://msh.rks-gov.net/Documents/Index/270> apo të kërkohen nga Ministria e Shëndetësisë në email adresën [msh.info@rks-gov.net](mailto:msh.info@rks-gov.net)

## VËREJTJA 1

Vërejtja e përgjithshme:

**DUHANI SHKAKTON KANCERIN E FYTIT**

Vërejtja e kombinuar:

(a) Fotografia



(b) Vërejtja shtesë

Ky duhanpirës është sëmurë nga kanceri i fytit. Laringu i tij është hequr dhe tash mund të merr frymë vetëm nëpërmjet të zgavrës në fytin e tij.


## VËREJTJA 2

Vërejtja e përgjithshme:

**DUHANI SHAKTON KANCERIN E GOJËS**

Vërejtja e kombinuar:

(a) Fotografia



(b) Vërejtja shtesë

Konsumimi i duhanit shkakton kancerin e gjuhës, buzëve dhe pjesëve të tjera të gojës. Trajtimi mjekësor përfshinë operacione që mund të deformojnë fytyrën tuaj.

### VËREJTJA 3

Vërejtja e përgjithshme:

**DUHANI SHKAKTON SËMUNDJE TË ENËVE TË GJAKUT**

Vërejtja e kombinuar:

(a) Fotografia



(b) Vërejtja shtesë

Konsumimi i duhanit ngushton dhe bllokton enët e gjakut, duke e reduktuar qarkullimin e gjakut dhe oksigjenit në gjymtyrët tuaja. Me kalimin e kohës, kjo shkakton dhimbje, plagë të hapura dhe gangrenë që shpie në amputimin e gjymtyrëve.

## **VËREJTJA 4**

Vërejtja e përgjithshme:

### **MBRONI FËMIJËT NGA TYMI I DUHANIT**

Vërejtja e kombinuar:

(a) Fotografia



(b) Vërejtja shtesë

Fëmijët që i ekspozohen tymit të duhanit preken nga sëmundje të rrezikshme të mushkërive, infeksione të veshit dhe përjetojnë sulme astmatike.

## **VËREJTJA 5**

Vërejtja e përgjithshme:

### **DUHANI DËMTON FËMIJËT ENDE PA U LINDUR**

Vërejtja e kombinuar:

(a) Fotografia



(b) Vërejtja shtesë

Duhani gjatë shtatzënisë zvogëlon qarkullimin e gjakut në placentë, kufizon oksigjenin dhe ushqyesit e tjerë të fëmijës. Duhani shton rrezikun për abortim, lindje të parakohshme dhe mundësinë që fëmija të lind me tru dhe trup më të vogël.

## VËREJTJA 6

Vërejtja e përgjithshme:

**DUHANI SHKAKTON KANCERIN E MUSHKËRIVE**

Vërejtja e kombinuar:

(a) Fotografia



(b) Vërejtja shtesë

Duhani shkakton kancerin e mushkërive, emfizemën dhe probleme të tjera të rrugëve të frymëmarrjes. Emfizema shkatërron qeset ajrore të mushkërive. Me kalimin e kohës, frymëmarrja vështirësohet. Ju filloni të vdisni ngadalë nga mungesa e ajrit.

## VËREJTJA 7

Vërejtja e përgjithshme:

### DUHANI VRET

Vërejtja e kombinuar:

(a) Fotografia



(b) Vërejtja shtesë

Kështu vjen vdekja nga kanceri i mushkërive. Barb Tarbox ka vdekur në moshën 42 vjeçare nga kanceri i mushkërive i shkaktuar nga pirja e duhanit.

## VËREJTJA 8

Vërejtja e përgjithshme:

**DUHANI SHKAKTON SULM NË ZEMËR**

Vërejtja e kombinuar:

(a) Fotografia



(b) Vërejtja shtesë

Duhani shkakton sëmundje të zembrës duke dëmtuar enët e gjakut dhe furnizimin e zembrës tuaj me gjak. Një vit pas lënies së duhanit zvogëlohet dyfish rreziku nga sëmundjet e zembrës.

## VËREJTJA 9

Vërejtja e përgjithshme:

**DUHANI ËSHTË VARËSI**

Vërejtja e kombinuar:

(a) Fotografia



(b) Vërejtja shtesë

Nikotina shkakton varësi. Pas një kohe të shkurtër ju do ta keni të vështirë të kontrolloni sasinë e duhanit që tymosni ose të lini duhanin. Shumë njerëz nuk e kuptojnë se janë të varur nga duhani deri në momentin kur provojnë ta lënë duhanin.

## VËREJTJA 10

Vërejtja e përgjithshme:

### DUHANI SHKAKTON SULM NË TRU

Vërejtja e kombinuar:

(a) Fotografia




(b) Vërejtja shtesë


Pirja e duhanit ngushton dhe bllokton arteriet në trurin tuaj. Bllokimi i arterieve shkakton sulm në tru. Sulmi në tru shpie në paralizim të përhershëm, dëmton të folurit, si dhe shkakton paaftësi dhe vdekje.

Libraria e Vërejtjeve Shëndetësore - SHTOJCA 2  
Knjižara zdravstvenih upozorenja - ANEKS 2

Ilustrimet e vendosjes së vërejtjeve shëndetësore në paketimet e produkteve të duhanit


Ilustracije postavljanja zdravstvenih upozorenja na pakovanja duvanskih proizvoda





- 1.1 Paketimet në formë kuboide me kapak flip top
- 1.2 Paketimet në formë kuboide
- 1.3 Paketimet në formë të qeses së xhepit me një palosje
- 1.4 Paketimet në formë të qeses së xhepit me dy palosje
- 1.5 Paketimet në formë të qeses së xhepit që qëndron vertikalisht
- 1.6 Paketimet në formë cilindrike
- 1.7 Paketimet në formë të kutisë krah me kapak që varet
- 1.8 Paketimet në formë të kutisë krah me kapak që hiqet
- 1.9 Paketimet në formë të tubit cilindrik njësh për puro
- 2.0 Paketimet e jashtme

1.1 Paketimet në formë kuboide me kapak flip top












1.4 Paketimet në formë të qeses së xhepit me dy palosje



1.5 Paketimet në formë të qeses së xhepit që qëndron vertikalisht










1.7 Paketimet në formë të kutisë krah me kapak që varet







1.9 Paketimet në formë të tubit cilindrik njësh për puro





Vërejtjet shëndetësore për paketimet e produkteve të duhanit për tymosje në formë kuboideZdravstvena upozorenja za kuboidna pakovanja duvanskih proizvoda za pušenje



**DUHANI SHKAKTON  
KANCERIN E FYTIT  
PUŠENJE UZROKUJE  
RAK GRILA**



Ky duhanpirës është sëmurë nga kanceri i fytit. Laringu i tij është hequr dhe tash mund të merr frymë vetëm nëpërmjet të zgavrës në fytin e tij.



Ovaj pušač je oboleo od raka grla. Njemu je grkljan uklonjen i sada može disati samo preko otvora na njegovom grlu.

Tymi i duhanit përmban mbi 70  
substanca që shkaktojnë kancerin

Duvanski dim sadrži 70  
supstanci koje uzrokuju rak

**DUHANI SHAKTON  
KANCERIN E GOJËS  
PUŠENJE UZROKUJE  
RAK USTA**



Konsumimi i duhanit shkakton kancerin e gjuhës, buzëve dhe pjesëve të tjera të gojës. Trajtimi mjekësor përfshinë operacione që mund të deformojnë fytyrën tuaj.



Pušenje uzrokuje rak jezika, usne i drugih delova usta. Medicinski tretman uključuje operacije koje mogu deformisati vaše lice.

Tymi i duhanit përmban mbi 70  
substancia që shkaktojnë kancerin

Duvanski dim sadrži 70  
supstanci koje uzrokuju rak

**DUHANI SHKAKTON SËMUNDJE  
TË ENËVE TË GJAKUT**

**PUŠENJE UZROKUJE  
ZAÇEPLJENJE KRVNIH SUDOVA**



Konsumimi i duhanit ngushton dhe bllokton enët e gjakut duke e reduktuar qarkullimin e gjakut dhe oksigjenit në gjymtyrët tuaja. Me kalimin e kohës, kjo shkakton dhimbje, plagë të hapura dhe gangrenë që shpie në amputimin e gjymtyrëve.



Pušenje sužava i začepljuje krvne sudove, smanjujući protok krvi i kiseonika u vašim udovima. Tokom vremena, ovo uzrokuje bolove, stvarajući otvorene rane i gangrenu što dovodi do amputacije udova.

**Tymi i duhanit përmban mbi 70  
substancë që shkaktojnë kancerin**

**Duvanski dimi sadrži 70  
supstancë që shkaktojnë kancerin**

**MBRONI FËMIJËT  
NGA TYMI I DUHANIT  
ZAŠTITITE DECU OD  
DUVANSKOG DIMA**



Fëmijët që i ekspozohen tymit të duhanit preken nga sëmundje të rrezikshme të mushkërive, infeksione të veshit dhe përjetojnë sulme astmatike.



Deca koja su izložena duvanskom dimu su pogođena opasnim plućnim bolestima, infekcijama uva i napadima astme.

**Tymi i duhanit përmban mbi 70  
substanca që shkaktojnë kancerin**

**Duvanski dim sadrži 70  
supstanci koje uzrokuju rak**

**DUHANI DËMTON FËMIJËT  
ENDE PA LINDUR**

**PUŠENJE ŠTETI  
NEROËNOM DETETU**



Duhani gjatë shtatzënisë zvogëlon qarkullimin e gjakut në placentë, kufizon oksigjenin dhe ushqyesit e tjerë të fëmija. Duhani shton rrezikun për abortim, lindje të parakohshme dhe mundësinë që fëmija të lind me tru dhe trup më të vogël.




Pušenje u trudnoçi smanjuje protok krvi u posteljicu, ograničava kiseonik i druge hranljive materije za bebu. Pušenje povećava rizik od pobačaja, prevremenog porođaja i mogućnost rođenja deteta sa manjim mozgom i telom.

**Tymi i duhanit përmban mbi 70  
substancia që shkaktojnë kancerin**

**Duvanski dim sadrži 70  
supstanci koje uzrokuju rak**

**DUHANI SHKAKTON  
KANCERIN E MUSHKËRIVE  
PUËNJE UZROKUJE  
RAK PLUÇA**



Duhani shkakton kancerin e mushkërive, emfizemën dhe probleme të tjera të rrugëve të frymëmarrjes. Emfizema shkatërron qeset ajrore të mushkërive. Me kalimin e kohës, frymëmarrja vështirësohet. Ju filloni të vdisni ngadalë nga mungesa e ajrit.

Tymi i duhanit përmban mbi 70  
substancë që shkaktojnë kancerin

Duvanski dim sadrži 70  
supstanci koje uzrokuju rak

**DUHANI VRET  
PUŠENJE UBIJA**



© The Edmonton Journal

Kështu duket vdekja nga kanceri i mushkërive. Barb Tarbox ka vdekur në moshën 42 vjeçare nga kanceri i mushkërive i shkaktuar nga pirja e duhanit.



© The Edmonton Journal

Ovako izgleda smrt od raka pluća. Barb Tarbox je umro u 42 godini zbog raka pluća kojeg je uzrokovalo pušenje.

Tymi i duhanit përmban mbi 70  
substanca që shkaktojnë kancerin

Duvanski dim sadrži 70  
supstanci koje uzrokuju rak

**DUHANI SHKAKTON  
SULM NË ZEMËR  
PUŠENJE UZROKUJE  
SRÇANI UDAR**



Duhani shkakton sëmundje të zemrës duke dëmtuar enët e gjakut dhe furnizimin e zemrës tuaj me gjak. Një vit pas lënies së duhanit zvogëlohet dyfish rreziku nga sëmundjet e zemrës.



Pušenje uzrokuje srčane bolesti oštećujući krvne sudove i snabdevanje krvlju. Godinu dana od prestanka pušenja, dvostruko se smanjuje opasnost od srčanih bolesti.

Tymi i duhanit përmban mbi 70  
substancia që shkaktojnë kancerin

Duvanski dim sadrži 70  
supstanci koje uzrokuju rak

## DUHANI ËSHTË VARËSI

PUŠENJE  
STVARA ZAVISNOST



Nikotina shkakton varësi. Pas një kohe të shkurtër ju do ta keni të vështirë të kontrolloni sasinë e duhanit që tymosni ose të lini duhanin. Shumë njerëz nuk e kuptojnë se janë të varur nga duhani deri në momentin kur provojnë ta lënë duhanin.



Nikotin stvara zavisnost. Nakon kratkog vremena teško ćete kontrolisati količinu duvana koju pušite ili prestanak pušenja. Mnogi ljudi ne shvataju da su zavisni od duvana sve dok nisu suočeni sa prestankom pušenja duvana.

Tymi i duhanit përmban mbi 70  
substanca që shkaktojnë kancerin

Duvanski dimi sadrži 70  
supstanci koje uzrokuju rak

**DUHANI SHKAKTON  
SULM NË TRU  
PUŠENJE UZROKUJE  
MOŽDANI UDAR**



Pirja e duhanit ngushton dhe bllokton arteriet në trurin tuaj. Bllokimi i arterieve shkakton sulm në tru. Sulmi në tru shpie në paralizim të përhershëm, dëmton të folurit, si dhe shkakton paaftësi dhe vdekje.



Pušenje sužava i zapušava arterije u vašem mozgu. Blokiranje arterija uzrokuje moždani udar. Moždani udar dovodi do trajne paralize, oštećenja govora, nesposobnosti i smrti.

Tymi i duhanit përmban mbi 70  
substancia që shkaktojnë kancerin

Duvanski dim sadrži 70  
supstanci koje uzrokuju rak



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria – Vlada - Government*

*Ministria e Shëndetësisë - Ministarstvo Zdravstva – Ministry of Health*

**ADMINISTRATIVNO UPUTSTVO (Zdravstvo) BR. 05/2023**  
**KOMBINOVANE UPOZORENJE**

## **Ministar Ministarstva Zdravstva,**

Uskladu sa članom 6 stavom 13, 18 i 19. Zakona br.04 / L-156 o kontroli duvana (Službeni list br. 13, 07/05/2013), Aneks 1, stav 6, pos stav 6.1 Uredbe br 14/2023 o oblasti administrativne odgovornosti Kancelarije premijera i ministarstava i članom 38. stav 6. Poslovnika o radu Vlade br.09 / 2011 (Službeni list br. 15, 12.09.2011),

Donosi:

### **NACRT ADMINISTRATIVNO ADMINISTRATIVNO UPUTSTVO BR. 05/2023 KOMBINOVANE UPOZORENJE**

#### **Član 1 Svrha**

1. Ovo Administrativno uputstvo definiše pravila za postavljanje fotografija u boji ili drugih ilustracija i tekstova na pakovanju duvanskih i njemu sličnih proizvoda u cilju:

- 1.1. boljeg informisanja pušača duvana o zdravstvenim posledicama pušenja duvana i upotrebe duvanskih proizvoda;
